



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS SKENDERAJ

Numri i lëndës: 2019:297207

Datë: 11.06.2024

Numri i dokumentit: 05806896

C.nr.653/19

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - DEGA NË SKENDERAJ, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Nderim Musa, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore, kundër të paditurit S.B., nga fshati..., Komuna e Skenderajt, me objekt kontesti, pasurim pa bazë, jashtë seance, me datë **11.06.2024**, mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSIDEROHET se është tërhequr padia me numër C.nr.653/19, e paditëses Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, me seli në Prishtinë, kundër të paditurit S.B., nga fshati..., Komuna e Skenderajt, lidhur me çështjen pasurim pa bazë.

A r s y e t i m

Paditësja ka ushtruar padi në këtë gjykatë, kundër të paditurit për kthimin e mjeteve mbi bazën e pasurimit pa bazë.

Gjykata ka caktuar seancën përgatitore me datë 11.06.2024, në të cilën ka prezantuar vetëm i i padituri, ndërsa paditësja nuk ka prezantuar. Meqenëse paditësja, respektivisht Avokatura Shtetërore thirrjen për seancë e kishte pranuar me rregull dhe mungesën nuk e kishte arsyetuar, kurse i padituri nuk ka propozuar që seanca të mbahet në mungesë të paditëses, gjykata padinë e paditëses e konsideroi të tërhequr.

Gjykata në kuptim të dispozitave nga neni 409 par. 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil

C.nr.653/19, të datës 11.06.2024

Gjyqtari
Nderim Musa

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.